

### Tregoni vëmendje për interesat e fëmijës

Historitë me figurat e dashura rrisin motivimin e fëmijës suaj për të lexuar. Ndhmojeni fëmijën tuaj për të gjetur librat, komikët apo revistat e duhura.



### Ndani së bashku dëshirën për të lexuar

Flisni me fëmijën tuaj për librat e tij. Kur shkëmbeni mendime kënaqeni dhe fëmija tuaj motivohet për të lexuar.



### Përdorni siç duhet mediat digjitale

Edhe kush përdor mediat digjitale, lexon. Kërkoni me fëmijën tuaj përdorime që ju ftojnë të lexoni dhe të jeni krijues.



### Vizitoni bibliotekat

Bibliotekat publike janë vende interesante për të kaluar kohën e lirë dhe ofrojnë shumë aktivitete për fëmijë. Zbuloni me fëmijën tuaj bibliotekat afër jush.



# Fëmija im mëson të lexojë

Kështu e mbështesni fëmijën tuaj kur fillon të lexojë.



SIKJM  
ISJM  
ISMR

### Flisni me fëmijën tuaj

Një gjuhë e përditshme e pasur është shumë e rëndësishme për të mësuar të lexosh.

Flisni me fëmijën tuaj në gjuhën në të cilën ndiheni më të sigurt.



### Çdo fëmijë ka ritmin e vet

Mësimi i leximit kërkon kohë dhe është i vështirë. E rëndësishme është që fëmija juaj të mos e humbë guximin, prandaj lavdërojeni shpesh për përparimet e tij.



### T'i lexosh fëmijës është një dhuratë

Lexojini fëmijës suaj rregullisht, edhe në fazën kur ai po mëson vetë të lexojë. Kështu mbani gjallë dëshirën e tij për të dëgjuar histori.



### Jini shembull

Fëmijët orientohen me shembuj. Tregojini fëmijës suaj që leximi luan rol në të përditshmen.



### Instituti zviceran për mediat për fëmijë dhe të rinj SIKJM/ISJM/ISMR

SIKJM/ISJM/ISMR angazhohet për letërsinë për fëmijë dhe të rinj. Ai zhvillon projekte që fëmijëve t'u zgjohet dëshira për letërsinë dhe për të lexuar dhe u tregon mësuesve dhe prindërve si t'i ndihmojnë fëmijët në zhvillimin e gjuhës dhe leximin.

Në faqen e internetit të SIKJM/ISJM/ISMR gjeni **këshilla mediash** për moshat dhe interesat e ndryshme, për të lexuar vetë ose për t'i lexuar fëmijës.

Me **ditën zvicerane të leximit** dhe **natën zvicerane të leximit** SIKJM/ISJM/ISMR bën dy aktivitete kombëtare, ku fëmijët dhe të rinjtë përjetojnë së bashku histori dhe tregime të bukura.

#### Informacione të mëtejshme:

[www.sikjm.ch](http://www.sikjm.ch) / [www.isjm.ch](http://www.isjm.ch) / [www.ismr.ch](http://www.ismr.ch)

**SIKJM  
ISJM  
ISMR**

Schweizerisches Institut  
für Kinder- und Jugendmedien

Institut suisse  
Jeunesse et Médias

Istituto svizzero  
Media e Ragazzi